



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca : 626-23-016-2-2-1

Me 07.03.2024

M a m u s h ë

Në bazë të Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, RREGULLORES 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 43 Paragrafi 43.5 pika (b) si udhëheqës i sektorit të Prokurimit bie këtë:

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-23-7240-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-016-2-2-1

II

Tenderi të rishpallet pas afatit ligjor për parashtrimin e ankesave eventuale.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 14.07.2023 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: "Servisimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës" me nr. të prokurimit 626-23-7240-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-016-2-2-1. Pas njoftimit për kontratë, dosjen e tenderit e kanë shkarkuar (8) Operator Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar vetëm tre (3) prej tyre, ku asnjëri prej tyre nuk ka qenë i përgjegjshëm bazuar në Vendimin e OSHP-s me nr. 2023/0676 dhe vlerësimin të komisionit ri-vlerësues.

Pas analizimit të provave dhe fakteve u konstatua që asnjëri nga O.E. pjesëmarrës nuk ka dorëzuar tender të përgjegjshëm në përshtatje me dispozitat e legjislacionit të prokurimit, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) të RREGULLORES 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi

Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

